



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembl

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 4
Prishtinë, më 25.02. 2014, në orën 11.00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në këtë mbledhje morën pjesë: Suzan Novoberdali – kryetare, Rita Hajzeraj – Beqaj, Biserka Kostiq, Kurtan Kajtazi, Albana Gashi, Justina Pula, Kymete Bajraktari dhe Kimete Bytyçi.

Mungoi: Justina Pula dhe Duda Balje.

Nga Stafi mbështetës i Komisionit: Reshit Gashi - Koordinator dhe Sulltane Gashi - zyrtare ligjore.

Pjesëmarrës të tjerë: Sead Bardhi-ZPRK, Albana Merja- GLPS, Dragana Duriq-RTK2, Ilir Krasniqi-Standardi Info, Visar Bivolaku-EU OFFICE-EUSR, Sami Salihu-MPMS, Minire Begaj-MPMS, Nexhat Sylja-MPMS Lejla Selimi- OSBE, Visar Bivolaku-EU OFFICE-EUSR, Nuredin Ibishi- UNDP, Burim Tahiri - UNICEF, Agon Vrenezi-OHCHR, Ukë Gashi-ZRPK, dhe Raba Gjoshi-YIHR KS.

Mbledhjen e kryesoi, Suzan Novoberdali- kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raportit të Panelit Rekrutues për përzgjedhjen e kandidatëve për Avokatin e Popullit;
3. Shqyrtimi i Peticionit nr. 04/5112/ Do-2123;
4. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës,

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Raportit të Panelit Rekrutues për përzgjedhjen e kandidatëve për Avokatin e Popullit

Kryetarja e përshëndeti Panelin rekrutues për punën që e ka kryer, rreth përzgjedhjes së kandidateve për Avokat të Popullit, falënderoj mediat dhe vëzhguesit që gjatë gjithë kohës kanë qenë në monitorim të procesit edhe gjatë intervistimit të kandidatëve.

Ajo tha se nga ana e panelit është bërë një punë transparente dhe e drejtë, intervistimi i kandidatëve ka qenë i njëjtë, me pyetje të njëjta për secilin kandidatë, nga 22 kandidatë të cilët ju kanë nënshtruar intervistimit, i kemi përzgjedhur 3, dhe 19, të cilët nuk janë përzgjedhur dhe kanë qenë të pakënaqur, për këtë unë e shpërndava një shkresë. Dikush nga këta kandidatë ka pasur ndikim në një portal i cili ka shpifur që paneli rekrutues, konkretisht kryesuesja paska ndikuar dhe manipuluar me këtë proces, fatkeqësisht kemi edhe kesi lloj portalesh, të nesërmen ka reaguar edhe KMDLNJ, për këtë e falënderoj z. Behxhet Shala, i cili ka reaguar dhe e ka përshkruar procesin në detaje dhe në mënyrë të drejtë ashtu siç ka qenë në realitet.

Të nderuar anëtarë të Komisionit unë kërkoj nga ju të deklaroheni se si ka rrjedhur krejt procedura e këtij procesi mbasi në bazë të atij reagimi ka dalë se unë kam manipuluar me ju, është mirë të shprehni të gjithë mendimin tuaj, dhe si Komision të dalim me një reagim ndaj kësaj shkrese.

Rita Hajzeraj-Beqaj - Tha se ndihet e shqetësuar për atë deklaram që është bërë në atë portal medial, vendimi për votim të fshehtë ka qenë vendim i panelit dhe nuk ka qenë

vendim i kryetares së Komisionit, organizatat të cilat na kanë monitoruar nuk kanë vërejtje lidhur me këtë, për mua si anëtare e Panelit dhe e këtij Komisioni gjithçka ka qenë transparente dhe nuk ka pasur asnjë parregullsi në këtë proces.

Biserka Kostiq- Tha se ka qenë prezent për dy ditë gjatë punës së Panelit rekrutues, si anëtare e panelit, prandaj ky shkrim nuk është atak vetëm në kryesuesen e Panelit, edhe pse përmendet emri i saj, është sulm për të gjithë ne se kemi qenë pjesë e procesit.

Ajo tha se të gjithë kandidatët kanë pasur trajtim të njëjtë, kohë të njëjtë, pyetjet të gjithëve u janë bërë të njëjta, prandaj për këtë e demantoj atë shkrim medias dhe distancohem unë e para si përfaqësuese e komunitetit jo shumicë.

Çdo gjë ka qenë e rregullt dhe propozoj që Komisioni të dalë me një reagim kundër këtij shkrimi.

Kurtan Kajtazi- Tha se ajo çka është shkruar në atë portal nuk qëndron fare, në panel kemi qenë anëtarët e të gjitha partive politike, procesi ka shkuar siç ka qenë e paraparë me ligj dhe me rregullore, janë zbatuar të gjitha procedurat, edhe nga organizatat monitoruese është vlerësuar ky proces dhe konsideroj se ky ka qenë procesi më i mirë deri më tani për përzgjedhjen e kandidatëve për Avokat të Popullit. Komisioni ka qenë i paanshëm, nuk ka pasur ndikime as nga partitë politike, të gjithë kandidatet i kanë pasur pyetjet e njëjta, të gjithë kanë pasur kohën e mjaftueshme për përgjigjeje, të gjithë janë pyetur a i kanë pyetjet e qarta, dhe në fund kryetarja secilin e ka pyetur se a kanë diçka për të shtuar.

Ai tha se në mesin e tyre ka pasur kandidatë që ja vlen për të qenë Avokat i Popullit, dhe mendoj se Parlamenti kësaj radhe ka kandidatë që ja vlen me votuar pa zvarritje të procesit.

Kymete Bajraktari- Tha se procesi ka qenë transparent, i rregullt nuk ka pasur asnjë lëshim dhe nuk pajtohem me shkrimet që shkruhen nëpër media.

Albana Gashi- Tha se procesi ka qenë mjaft i rregullt dhe transparent, këtu po shoh se burimin të cilin është thirrur ky portal, e ka cilësuar si tendencë për t'i eliminuar kandidatet në mënyrën e vlerësimit. Unë qëndroj pranë asaj që e kam thënë edhe ditën kur

është bërë vlerësimi, se a jepen 10 pikë apo 100 pikë është çështje që i takon anëtarit të panelit. Madje nëse është vlerësuar se kandidati nuk ka dhënë përgjigje qysh duhet, ke pasur të drejtë me vlerësuar edhe me zero poenë.

Kështu që nuk po me duket e arsyeshme me dalë me reagime se ka pasur tendenca për të eliminuar kandidatë, nuk duhet të merremi shumë me këtë problematikë, emrat shumë shpejt do të procedohen për në Kuvend dhe të zgjidhet Avokati i Popullit.

Kryetarja- Tha se me portale të rrejshme nuk duhet të merremi dhe as qytetarët nuk duhet të ju besojnë, dhe se ky portal vetveten e ka degraduar se ushqehet me informacione të rrejshme dhe konkluzionet i bën të rrejshme. Ne, si Komision, jemi të pajtimit ta bëjmë një reagim të qartë lidhur me këtë, dhe tani po vazhdojmë me raportin e panelit.

Ajo fillimisht tha se kërkon një votim, sepse rregullorja përcakton se mbledhja e Komisionit kur të shqyrtohet raporti është e mbyllur. Mirëpo mund ta bëjmë një përjashtim dhe nëse pajtohemi këtë raport ta shqyrtojmë në mënyrë të hapur, në prezencë të të gjithëve edhe të mediave.

Komisioni në mënyrë unanime vendosi që mbledhja të jetë e hapur dhe raporti të shqyrtohet në prani të vëzhgueseve dhe të mediave.

Kryetarja- Tha se raportin e kem para vetes dhe është përshkruara puna e panelit dhe ecurit e këtij procesi, më 18 dhe 19 shkurt është zhvilluar intervistimi i kandidatëve, kemi pasur gjithsejtë 25 aplikues që janë ftuar në intervistë, njeri prej tyre është tërhequr dhe dy të tjerë kanë munguar, paneli ka vendosur që vlerësimi të bëhet me vota të fshehta. Paneli ka vlerësuar secilin kandidatë, numërimi i fletëvotimeve ka qenë transparent në prezencë të monitoruesve, në fund kemi mbledhur pikët dhe tre kandidatët që kanë pasur pikë më së shumti janë përzgjedhur që të procedohen në Komision dhe pastaj pas miratimit të raportit të procedohen në kryesi dhe pastaj të procedohen për seancë plenare.

Tre kandidatët të cilët janë vlerësuar me më shume pikë janë Hilmi Jashari, Gjyljeta Mushkolaj dhe Adriana Hoxhiq. Në fund të procesit kemi nënshkruar të gjithë dhe me qaq e kemi përmbyll punën e panelit rekrutues në përzgjedhjen e tre kandidatëve.

Ajo tha se raporti e pasqyron punën e panelit dhe nëse dikush ka për të shtuar diçka lidhur me këtë raport mund ta marrë fjalën.

Kimete Bytyçi- Tha se na njoftuat që keni mbajtur trajnim dhe ju përshëndes për punën që e keni bërë, pas asaj që ju e thatë këtu dhe punën që e prezantuat, mua po më duket se gjithçka ka qenë në rregull edhe sipas dokumentacionit dhe rregullave që keni proceduar. Jam që të bëhet një reagim kundër atij shkrimi medias që është bërë dhe që ka dhënë informata të pasakta për këtë proces.

Kryetarja konstaton se Komisioni në mënyrë unanime vendosi të nxjerrë këtë:

R e k o m a n d i m

I rekomandohen Kuvendit për votim kandidatët për Avokat të Popullit, të radhitur në bazë të alfabetit, sipas mbiemrit, si vijon:

1. Adrijana Hoxhiq,
2. Hilmi Jashari dhe
3. Gjyljeta Mushkolaj.

3. Shqyrtimi i Peticionit nr. 04/5112/ Do-2123,

Kurtan Kajtazi- Tha se një parashtrues nga Suhareka ka sjellë një shkresë, i cili përmes kësaj shkrese të tij personale synon se ju kanë shkelur disa të drejta të tij, nga ana e gjyqësorit dhe thotë se i është degraduar imazhi i tij, gjithçka është e paqartë në këtë shkresë e cila më shumë është informatë, lëndët janë gjyqësore.

Ne, si Komision, kur lëndët janë në gjykatë nuk kemi të drejtë të ndërhyjmë në proceset gjyqësore.

Kryetarja konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime vendosi të nxjerrë këtë:

Përfundim

Komisioni nuk ka kompetencë të shqyrtojë dhe të ndërhyjë në lëndët të cilat janë në proces gjyqësor.

4. Të ndryshme.

Kryetarja- Tha se ka një propozim që në një tryezë të ftojë Agjencinë për Barazi Gjinore dhe të na njoftojë për punën e tyre pak më gjerësisht se çka kanë ndërmarr për avancimin e Barazisë Gjinore nëpër institucione.

Ajo tha se në një bisedë me NDI dhe me grupin e grave deputete, mendohet të bëhet një takim i përbashkët, kjo do të jetë një nismë e Komisionit tonë, nëse jeni të pajtimit.

Kymete Bajraktari- Tha se kjo është edhe një kërkesë e kahershme që Agjencia për Barazi Gjinore me raportuar para Komisionit, por paraprakisht është mirë që të na i ofrojnë një raport me shkrim lidhur me shpenzimin e buxhetit dhe aktivitete e tjera.

Kryetarja konstatoi se Komisioni unanimisht vendosi të nxjerrë këtë;

Përfundim

Komisioni më 10 mars 2014, në orën 11.00, do të organizojë tryezë, ku të ftuar do të jenë Agjencia për Barazi Gjinore, Grupi i grave deputete dhe organizatat jo qeveritare që merren me barazi gjinore.

Mbledhja përfundoj në orën 11:30.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdali